



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr.97 Datë 07 / 09 /2023

“ PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË ”

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “ b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr.459, datë 3.7.2019 “ Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirase ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehimin”, bazuar në kërkesat e qytetarëve, në bazë të kërkesës së ardhur nga qiramarrësja, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **07.09.2023** me 22 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për familjen e **znj. Shyqyrie Fisniku**, në vlerën prej 10.000 lekësh.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë deri në muajin Janar 2024.
3. Për familjen, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pageses do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorisë Ekonomike, referuar kontratës të qirasë noteriale.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtorja e Ekonomike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit.
5. Vendimi u shpall me datë **07.09.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

